

sagemax<sup>®</sup>



Udhëzimet e përdorimit

---

# WAX Disc

për teknologjinë CAD/CAM dhe të shtypjes

[sagemax.com](http://sagemax.com)

### **Përshkrimi**

"Sagemax WAX Disc" është prodhuar për krijimin e restaurimeve të dyllit me teknologjinë CAD/CAM. Rastet e përdorimit përfshijnë restaurimet e dyllit dentar të prodhuar me teknologjinë CAD/CAM për teknologjinë me shtypje-derdhje.

### **Karakteristikat**

- |                       |                        |
|-----------------------|------------------------|
| › Përbërja kimike     | Dyllë sintetik         |
| › Ngjyra:             | Blu                    |
| › Pika e shkrirjes:   | 100-120°C              |
| › Dendësia:           | 0,92 g/cm <sup>3</sup> |
| › Tretshmëria në ujë: | I patretshëm           |

### **Indikacionet**

- › Prodhimi i restaurimeve të dyllit dentar të prodhuar me teknologjinë CAD/CAM për teknologjinë e shtypje-derdhjes.

### **Kundërrindikacionet**

- › Nuk miratohet për përdorim të drejtpërdrejtë në gojën e pacientit.

### **Shënime në lidhje me dizajnin**

Për dizajnin, ndiqni udhëzimet e prodhuesit për aliazhin përkatës dhe qeramikën e shtypjes.

### **Përpunimi me CAD/CAM**

"Sagemax WAX Disc" mund të përpunohet në sistemet dentare të frezimit CAD/CAM (ndiqni udhëzimet e prodhuesit).

Përdorni vetëm mjetet e frezimit të rekomanduara për këtë sistem frezimi kur përpunoni materialin. Temperatura e punës së ambientit nuk duhet të tejkalojë 35°C.

### **Përpunimi pas frezimit**

#### **Lëmimi**

Pas frezimit, ndani objektin e përpunuar nga disku duke përdorur një frezë tërthore prej karbidi volframi. Çdo punim apo rregullim i përfunduar sipas formës duhet të kryhet duke përdorur freza tërthore prej karbidi volframi. Materiali mund të përmirësohet duke përdorur dyllë modelimi tradicional.

### **Montimi i kanaleve të derdhjes**

Rregullat e zgjedhjes dhe pozicionimit të duhur të kanaleve të derdhjes varen nga aliazhi i përdorur. Informacioni i detajuar në lidhje me aliazhet mund të gjendet në udhëzimet përkatëse të prodhuesit.

### **Veshja**

Shtrojeni pjesën e brendshme të unazës së derdhjes me lëndë izoluese qeramike. Përzieri materialin e veshjes dhe visheni në vakum. Ndiqni udhëzimet e prodhuesit të materialit të veshjes dhe aliazhin që do të përdoret.

### **Ruajtja**

- › Ruajeni në 10-32°C.
- › Mbrojeni nga drita e drejtpërdrejtë e diellit.
- › Mbajeni larg fëmijëve!

### **Hedhja**

"Sagemax WAX Disc" përbëhet nga dyllë i pastër sintetik. Mbetjet mund të përdoren për raste të tjera përdorimi të zakonshëm të dyllit. Dylli mund të hidhet me mbetjet e përgjithshme shtëpiake.



Prodhuar nga

**Sagemax Bioceramics, Inc.**  
34210 9th Ave. South, Suite 118  
Federal Way, WA 98003, USA  
**P** +1-253-214-0389  
**E** info@sagemax.com

**RX only**

Vetëm për përdorim stomatologjik

Ky material është zhvilluar vetëm për përdorim në stomatologji dhe duhet përpunuar në përputhje me udhëzimet. Nuk mbajmë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga keqpërdorimi apo mosrespektimi i udhëzimeve. Përdoruesi është përgjegjësi i vetëm për testimin e materialit për përshatshmëri për çfarëdo qëllimi që nuk përcaktohet shprehimisht tek udhëzimet. Kjo vlen edhe për rastet kur materialet përzihen apo përdoren së bashku me produkte nga kompani të tjera.

© 2022 Sagemax Bioceramics, Inc.  
SQ/2022-09/Rev.2

sagemax.com

sagemax®